




Përmbledhje e rekomandimeve nga raportet e vlerësimit

Zyra për sigurim të cilësisë

UIBM



Hyrje

UIBM ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, ka një rol të veçantë në këto zhvillime dhe është organi kryesor brenda UIBM për matjen e cilësisë së brendshme.

Cilësia është përgjegjësi e të gjithëve dhe secilit!





Në muajin Janar dhe Maj 2022, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda UIBM, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në UIBM, përmirësimit të mësimdhënies si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm përkitazi me metodologjitë e reja, dhe rritjes së përgjegjësisë së stafit menaxhues, ZSC-ja ka realizuar pyetësonin me studentët e UIBM, në nivelin Bachelor dhe Master, si një proces tashmë i zakonshëm.



UIBM garanton se:

I gjithë procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit studentë dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit.

Në vazhdim, do të paraqesim një përmbledhje të rekomandimeve që janë nxjerrë nga pyetësori.

Me qëllim që raporti të ruaj etikën e secilit dhe atë të institucionit, do të gjeni të publikuara vetëm disa nga rekomandimet kryesore të pyetësorëve.



Gjetjet e pyetësorëve



Pyetësori është plotësuar nga të gjithë studentët që kanë paraqitur provimet në afatin e rregullt të provimeve. Nga të gjeturat studentët kanë qenë të sigurtë në përgjigjet e tyre, dhe kemi pranuar shumë komente dhe sugjerime që tregojnë interesimin e tyre që të kontribuojnë në proceset në UIBM.

Ky raport shpreh vetëm statistikat e përgjithshme, dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve. Ndërsa, raportet për rekomandimet për fakultetet veç e veç, si dhe për secilin profesor, ZSC-ja i ka dërguar tek Dekanët e fakulteteve, dhe ata do t'i diskutojnë gjetjet me stafin e tyre akademik.





Rekomandimet

Zyra e cilësisë e UIBM, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve të nivelit Bachelor dhe Master në këtë pyetësor, dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UIBM-së që të merren hapat si më poshtë:



Përmbledhje e rekomandimeve #1

01.

Vizita



Organizimi i më shumë vizita studimore në institucione.

02.

SMU



Të obligohet stafi akademik që ti vendosin materialet e ligjëratave dhe ushtrimeve në SMU.

03.

Koordinimi



Koordinimi i ligjëratave dhe ushtrimeve në mes profesorëve dhe asistentëve për bashkërendim të temave që ligjërohen.

04.

E-shërbime



Krijimi i mundësive për ofrimin e shërbimeve administrative online për studentët.

05.

Biblioteka



Zgjatja e orarit të bibliotekës.

06.

Hulumtime



Ofrimi i përkrahjes për hulumtimet dhe punimet shkencore të studentëve.

Përmbledhje e rekomandimeve #2

07.

Rekreacioni →

Investime në projekte rekreative për studentët.

08.

Web →

Pasurimi i webfaqes së UIBM-së me përmbajtje shkencore.

09.

Infrastruktura →

Pajisja e të gjitha kabineteve me kompjuter, printer dhe internet.

10.

Digjitalizim →

Vendosja e projektorëve dhe tabelave smart në klasa

11.

Biblioteka →

Rritja e numrit të titujve të librave në bibliotekë.

12.

Mësimdhënja →

Të investohet vazhdimisht në trajnimin e stafit akademik për metodat e mësimdhënies.

Përmbledhje e rekomandimeve – ALUMNI #3

13.

Praktika →

Të rritet numri i orëve për punë praktike.

14.

Lëndë specifike →

Të ofrohen më shumë lëndë zgjedhore që lidhen direkt me fushën e studimit dhe profesionin.

15.

Bashkëpunim →

Bashkëpunim më i lartë në mes profesorëve të fushave të njejta.

16.

Mobiliteti →

Të arrihen sa më shumë marrëveshje me IAL-të tjera, vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar mobilitet të studentëve.

17.

Asociacioni →

Të fuqizohet edhe më tepër Asociacionin ALUMNI (përfshirë aspektin financiar për aktivitete të ndryshme).

18.

Laboratorët →

Laboratorët të jenë më të qasshme për studentë (të realizojnë detyra dhe eksperimente nën monitorim)

Faleminderit!

Keni ndonjë pyetje?

umib.net

